



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.32, datë 21.01.2022

PËR
MIRATIMIN E ZGJEDHJES SË ANËTARIT NË VENDIN VAKANT TË KOLEGJIT
ZGJEDHOR GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në ligjin nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 146 të Kodit Zgjedhor miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 31, datë 20.01.2022 “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor”, si dhe në shortin e hedhur më datë 21.01.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjedhjen e anëtarit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Znj. {...} delegohet në këtë detyrë deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar të anatarëve të miratuar me vendimin nr.293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR